

V E N D I M
Nr.286, datë 30.5.1994

PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHETITIT nga
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të neneve 7 dhe 8 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Mjetet e punës, lëndët e para, materialet, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet që kanë shërbyer si mjet për kundërvajtjet administrative, për të cilat organet administrative që i kanë shqyrtuar këto kundërvajtje kanë vendosur kalimin e tyre në dobi të shtetit dhe vendimet kanë marrë formë të prerë, të administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit dhe të konsiderohen mall rezervë i shtetit.

Evidencimi për marrjen në dorëzim të sendeve të mësipërme të bëhet me fletëhyrje në bazë të procesverbalit të mbajtur nga organi administrativ përkatës dhe degët e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Shtetërore në rrethe, në sasinë e në vleftën e llogaritur mbi bazën e çmimeve të mundshme.

2. Sendet e përcaktuara në pikën 1, për të cilat vendimet për kundërvajtje administrative nuk kanë marrë formë të prerë, administrohen nga organet administrative që kanë vendosur kalimin e tyre në dobi të shtetit.

Kur vendimi për kundërvajtjet administrative merr formë të prerë për këto sende, të veprohet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Sendet që janë të transportueshme ose lehtësisht të transportueshme, si automjete, motoskafe, barka etj., të magazinohen në mjediset e Rezervës së Shtetit.

Sendet jashtë çdo mundësie transportimi e magazinimi, si anije, vagonë trenash etj., si dhe mallrat e materialet që kërkojnë kushte speciale ruajtjeje, si mish, gjalpë etj., do të konsiderohen si mall në ruajtje rezervë e shtetit për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës së Shtetit. Në ruajtje i mban personi juridik që vepron në territorin ku ndodhet sendi që ka shërbyer për kundërvajtjen administrative, ose personi juridik shtetëror a privat që siguron kushtet e ruajtjes speciale. Në këtë rast mbahet procesverbal i marrjes në dorëzim të sendit ndërmjet organit administrativ që ka vendosur për kundërvajtjen, rezervës së shtetit dhe personave juridikë që do t'i mbajnë këto mjete në ruajtje. Për ruajtjen e sendeve mund të kërkohet ndihmë nga Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Mbrojtjes. Në këto raste drejtoria dhe degët e Rezervës së Shtetit ose organi administrativ përkatës duhet të paraqesin kërkesë me shkrim në këto organe.

4. Sendet e përcaktuara sipas pikës 1 bëhen objekt shitjeje ose transferimi pa pagesë në institucione me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Shitja e tyre do të bëhet sipas procedurave të shitjes së mallrave rezervë e shtetit. Arkëtimet e realizuara përdoren me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

5. Të gjitha sendet e përcaktuara në pikën 1, të cilat ndodhen pranë organeve administrative në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të kalojnë në Rezervën e Shtetit.

6. Në zbatim të këtij vendimi, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervës së Shtetit, të nxjerrin udhëzimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi